



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



**PROCESVERBAL I MBAJTJES SË MBLEDHJES TRETË TË KKSB-së
PËR VITIN 2018**

R E N D D I T E

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Prishtinës nga Policia e Kosovës;
3. Trafikimi i qenieve njerëzore dhe përdorimi i substancave narkotike.
4. Realizimi i takimeve me anëtaret e komunitetit për pjesëmarrjen aktive në takimet e forumeve të sigurisë.

5.Të ndryshme.

Selim Pacolli nënkyrjetar i Komunës e hapi mbledhjen duke i përshëndet të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Pika e parë e Procesverbali i mbledhjes së kaluar të ditës u miratua nga të pranishmi të KKSB-s

Hetem Kupina Kryesues i KLSP-së -Bardhosh kërkoj që të jetë ne rendin e ditës edhe dukuri e marrjes se parave me fajde dhe masat qe duhet te ndërmerren për ta luftuar këtë veti shumë të rrezikshme dhe të dëmshme për qytetaret. Dhe njëherit falënderojë Fatmir Bilallin koordinatorin e KKSB-së për mbajtjen e mbledhjeve me rregulle dhe korrektësinë e tij.

Selim Pacolli nënkyrjetar i Komunës e njoftoj se kjo pike është e paraparë në këtë mbledhje .

Pika e dytë e rendit të ditës, Informatë lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës nga P.K. në këtë pikë të rendit të ditës raportuan tre Komandantet e Stacioneve të Policisë.

Shkelzen Gjafa – komandat i stacionit policor qendra i cili tha: sa i përket zonës së sigurisë e vlerësojmë të qetë, dhe se në këtë muaj është ngrit niveli i sigurisë për arsyet e frekuencës me të madh nuk ka prishje te mëdha të rendit kemi një ngritje te masave preventive duke u bazuar ne planin 6 mujore ka rënie të veprave për kundërvajtje dhe prishje të rendit dhe qetësisë 9.39% , ndërsa ka ngritje 68.6% apo 166 raste , vetëm në rrugën "Rexhep Luci " ka pasur 52 raste të iniciuara . Kemi pasur një ngritje prej 36.70% në luftimin e veprave falsifikim i parave , ndërsa sa i përket shkaktimit të irrezikut të përgjithshëm është 53.7%, te trafikimi me qenie njerëzore ka një ngritje prej 5.5% tanë duke u bazuar ne terren kemi një ngritje të sulmeve ndaj zyrtareve gjatë kryerjes së punëve, në amnesti kemi ngritje 99% apo 291 raste , ndalim arrestimi kemi një rritje. Ndërsa sa i përket problemit me fajde policia ka hartuar një plan duke përfshirë aktivitete të ndryshme në vedisimin e

masës për te iniciuar dhe lajmëruar rastet e veprave në këtë lëmi qe pastaj policia te veproje me mekanizma të vet.

Gani Berisha- Komandant i stacionit policor të jugut duke ju referuar mujeve të fundit ,testimin e kamerave nëpër bulevardë të qytetit, planit operativ për droga , pastaj masave te marra kundër aksidenteve ne trafik kemi një rënje të lehte pothuajse për të gjitha veprat penale . Në dy ditët e fundit kanë ndodhur dy grabitje në Zonën Industriale dhe në qytet një person ju ka nxjerre problem qytetareve , pastaj vjedhje në QKUK ku kane qene te përfshirë 5 (pesë) persona , tani gjendja e sigurisë është e mirë.

Safet Jashari- Komandanti i stacionit policor të veriut gjendjen e sigurisë për ketë rajon e vlerësojë të qetë dhe stabile edhe pse është multietnike duke marre parasysh edhe masat preventive qe janë ndërmarrë nga policia dhe takimet e shumta me qytetare ne fshatrat e Gollakut për parandalimin e veprave penale kemi bashkëpunim të ngushtë me banoret pastaj strukturat e sigurisë KLSP-ve të kësaj ane . Task forca e trafikut ne muajt e fundit ka dhënë rezultate pozitive . Është ne rritje gjendja e sigurisë në fshatrat Mramor ,Slivovë, Keqekollë ku në këtë fshat është formuar KLSP do të themelojmë së shpejti edhe një në qytet në Kodrën e Trimave e te cilat po ndikojnë shumë në sigurinë e qytetarëve, pastaj në parandalimin e të rinj eve për dukurit negative me trajnime te ndryshme kundër përdorimit te drogës te të rinjtë tanë . Rastet e përgjithshme kemi një rënje prej 12% , 27% kemi rritje të aktiviteteve preventive . Nënkryetari tha se kemi një ankesë me shkrim nga Brahim Ademi nga forumet e sigurisë lokale u kërkua marrja e masave të nevojshme për fshatrat Siqevë, Sharban dhe Keqekollë lidhur me dukurin e vjedhjeve të bagëtive . Krahasuar me vitet e kaluara ka me pak raste të hedhjes së bagëtive në pesetat e ujerave dhe se dukuria e vjedhjeve të bagëtive është zvogëluar tha Komandanti i policisë .

Ilmi Vitia - tha se deshta të ndërlidhem me ankesat e qytetarëve të cilët po i drejtohen policisë për çështje të ndryshme , pra qytetaret duhet së pari ti paraqesin problemet dhe shqetësimet e tyre mbledhje të KLSP-së dhe ne ua përcjellim organeve përkatëse sepse jemi urë lidhëse mes qytetareve dhe policisë .

Komandati i policisë njoftoj për rrjetet rreth parcelës së paraparë për ndërtimin e stacionit policor është duke u finalizuar procedura në Gjykatë . Shfrytëzojë rastin që ta falënderoje nënkryetarin e Komunës Selim Pacolli për angazhimin e tij maksimal dhe për një kohë të shkurtër ka arrit ta përbyll këtë kërkese jetike për polisinë i cili rajon përfshinë 42 fshatra dhe një pjesë Urbane të qytetit . Falë angazhimit të gjithëve ky këshill po funksionon shumë mirë.

Pika e tretë -Trafikimi i qenieve njerëzore dhe përdorimi i substancave narkotike.

Shkëlzen Gjafa komandant i policisë qendra tha se për ta luftuar këtë dukuri negative duhet së bashku të bëjmë një plane për mënyrat e veprimit dhe te koordinohemi me të gjitha institucionet gjegjëse qe ndikojnë në këtë çështje organizmat Komunal, bashkësítë fetare OJQ-të. Pastaj njoftimi i policisë për mbajtjen e manifestimeve siç ishte "Birra Fest." E patëm rastin e një 19 vjeçare ka pasur ngacmimi te parku qytetit për shkak te veshjes provokuese , 8 raste te gjuajtjes me armë, duhet të punojmë së bashku për respektimin e orarit të punës së lokaleve , pastaj në bash punim me Inspeksionin të bëjmë mylljen e diskotekave të jashtëligjshme, ndalimi i marrjes pjesë të peronave nën moshën 18 vjet siç ishte "Birra Fest ". Ne aspektin e prostitucionit moshat e kapura zakonisht janë te rinjtë dhe nuk dënohen për veprë penale .Sa i përket lojërave te fatit apo bastoreve kemi marre aksion e Ministrin e Administratës Tatimore dhe Inspektionin kemi shqiptuar 30 tiketa në 6 mujorin e parë ka funksionuar preventiva.

Safet Jashari komandant i policisë veriu mënyra dhe qasje për këtë dukuri të jetë e koordinuar të, veprojmë përgjegjshëm ,përdoruesit e drogave janë viktima të shkaktuara nga trafikantët të cilët edhe kur nxihen marrin dënimë të lehta , prandaj duhet ngritur çështjen në nivel vendi duke përfshirë akteret e ndryshëm që ndikojnë në siguri.

Gani Berisha komandant i policisë së stacionit jugu tha se nuk duhet të punojmë në koordinim të plotë me Inspektionin komunal rrëth mbylljes së lokaleve që tejkalojnë orarin e rregullt me leje të organeve gjegjëse . Sa i përket asaj në Dardani ku në podrumet e banesave ka keqbërës te ndryshëm dhe përdorues të drogave qytetarët duhet të lajmërojnë policinë në mënyre që të marrim masat e duhura si organë të rendit .

Lulzim Shehu përfaqësues fetar i tarikateve propozoj që nga kjo mbledhje të dalim me një plan veprimi përmarrjen e masave përmoshën nën 18 vjeçare.

Premtime Preniqi- Koordinatore përdrejtat e njeriut dhe barazi gjinore – tha se sa i përket çështjes së veshjeve provokuese nuk mundet të jete shkas përmgacimim seksual aspak nuk e përkrahu diskutimin e komandantit të policisë dhe ju si organ i sigurisë duheni të punoni edhe me ngacmuesin se kemi raste kur qytetarja është e veshur në mënyrë të thjesht dhe prapë prej njerëzve të tillë ka ngacmime këtë e them me përgjegjësi të plotë. Prandaj secili e ka të drejtën të vendos si të vishet dhe ti sigurohet qasje e lirë dhe pa ngacmimë nga të tjerët.

Një grup nga Komuna kemi punuar në një projekt në bashkëpunim me UN- HABITAT me temën , „Fuqizimi i të drejtës ndaj qytetit përmë gjithë “ lidhur me qeshjen e sigurisë së femrave ndaj ngacmimive seksuale dhe kemi bere edhe ecjen e sigurisë ditën dhe natën pikërisht ne park të qytetit dhe rrëth tij dhe te Korpusi Universitar , ku kemi identifikuar një hapësirë që përmë veç se përmë femra, e rrezikshme ka qen dhe e pa sigurt edhe përmë meshkujt.

Ngacmuesit qofshin ata që kanë një kulturë të ulët edukate ,ndonjë përdorues substancave narkotike apo edhe të sëmurit mendor të cilët sillen në tërë qytetin duhet të trajtohen konform ligjit dhe me këtë rast pastaj edhe qytetarët dojenë të sigurt të lëvizin lirshëm dhe besoj që edhe policia do ketë më pak raste të intervenimit .

Fatmir Bilalli koordinator i mbledhjes se KKSB-së ku po obligohen peronat kyç të jenë në mbledhje siç janë Drejtori i Drejtorisë së Arsimit pastaj Dren Kukaj Drejtor i Pronës duhet ti ftojmë të vine dhe të paraqesin opinionet e tyre.

Gani Berisha komandant i policisë propozon edhe përfaqësuesit e Inspektionit komunal .

Selim Pacolli nënkyrjetar i komunës tha se ne kohen kur femrat kane ecur rrugës te mbuluara nuk kemi pas raste të tillë të ngacmimit seksual, shpesh herë ka ndikuar edhe veshja shumë provokatore të nxis ngacmimin.

Safet Jashari komandant i policisë pajtohem ne parim me nënkyretarin sepse raste te hapura në polici motivi me i shpeshtë që e ka shty personin përmë vepër penale del të jetë provokimet si në plazhe dhe veprimet provokuese nga femrat dhe mënyrën e sjelljes ,por tash kane ndërruar motivi dhe janë me shume raste individuale dhe jo në numër të madh. Dukuri shqetësuese është edhe prezanca e të miturve nëpër lokale të natës ku përgjegjës direkt janë familjet e tyre KLSP-te duhet të mbajnë këshilla me këtë gjeneratë përmë vedisimin e tyre dhe pasojat që sjellin këto sjellje devijonte.

Lulzim Shehu përfaqësues fetar i tarikateve jemi dëshmitarë që ky fenomen i pubertetit është proces i zhvillimit ku pragu senzitiv është më i lartë .

Pika e katërt Realizimi i takimeve me anëtaret e komunitetit për pjesëmarrjen aktive në takimet e forumeve të sigurisë.

Heten Kupina KLSP Bardhosh flas ne cilësinë e kryesuesit gjendja e sigurisë është e shkëlqyer asnjë ekses ndëretnik nuk kemi ,mbledhje e KKSB-së i mbajmë me rregull ku çdo herë është prezent edhe komandanti i policisë për këtë rajon dhe ne jemi ata që i marrim informatat për gjendjen e sigurisë dhe me pastaj në bashkëpunim me organet e rendit i qasemi problemit për zgjidhje .

Violeta Hasni KLSP-Qendra takimet i ka te rregullta është hera e tretë që KLSP e jonë ka adresuar problemet të ndryshme dhe komuna na ka përkrahë për zgjidhjen e tyre .Takimet janë te hapura për qytetare shumë transparente ku të pranishëm janë zyrtaret komunal dhe policor që unë po mendojë që është krijuar një urë lidhëse për zgjidhjen e problemeve . Për zvogëlimin e zhurmës falënderon policinë e stacionit Qendra . Meqë tash për momentin kemi vetëm 4 kafi teri të zhurmshme që vazhduar me avazin e njëjtë . Kush ka pakënaqësi mund të jetë prezent në takime tona pasi që kam hasur në vështirësi me disa njerëz ,deri sa zëri im ka përfaqësuar komunitetin dhe jo atë personal dhe se çdo veprim përfshin shumicën dhe në të mirë të komunitetit . Edhe njëherë e falënderoje stacionin policor Qendra dhe Komunën e Prishtinës në veçanti DSHPMSH për bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve gjithashtu edhe OSCE-në ku ne bashkëpunim me ta kemi realizuar dy projekte , ku dhe qytetaret e komunitetit janë njoftuar .

Safet Kamberi KLSP-së Dardani përshtëndeti te pranishmit dhe i paraqiti problemet e Lagjes duke i klasifikuar në 5 pika : Te rruga Bill Klinton është shume rrezik qe të bien copa ndërtimit të kulmit të ndërtesave ;Te rruga "Ilaz Kodra" janë dy kabllo te rrëymës me tension të lartë të zhveshura në dy vende. Te qeshma e bardhë dhe te market viva është daluar kanalimi në sipërfaqe të rrugës është rrezik për ndonjë epidemi ; Para shkollës "Xhemajl Mustafa " qe 5 (pese)vite nuk është rregulluar infrastruktura ka gropë dhe rrjedhin ujerat fekale; Pastaj te rruga "Venhari "tash e 5 (pese) vite janë te hapura gropat dhe janë rrezik permanent për qytetareve.

Fatmir Koliqi përfaqësues i fesë katolike tha se është hera e parë që marre pjesë në këtë mbledhje, por falënderojë policinë e Kosovës se çdo problem qe kemi pas te katedralja Nena Terezë gjatë punimeve dhe çështjeve te tjera lidhur me ne na janë përgjigjur dhe na kanë përkrahur në zgjidhjen e tyre ne mënyrën më të mire te mundshme. I dëgjoja me vëmendje diskutimet për drogën dhe masat qe duhet ndërmarrë për te rinjtë tanë. Kisha qe 10 vite ndihmon familjet qe kanë familjaret përdorues drogë duke mbajt takim me familjaret e tyre çdo të shtune dhe se i kemi dërguar një numër të madh përmes kishës për tu rehabilituar ne Kroaci dhe kemi një bashkëpunim të mirë dhe kemi pasur sukses në këtë aspekt.

Dejan Millutinoviq përfaqësues i komunitetit serb – duke filluar nga Kodra e trimave e deri ne bernice e poshtme është shumë e ndotur ku ka shuine mbeturina përgjatë rrugës .

Selim Pacolli Nënkyryetari i Komunës tha se këtë problem e ka paraqitur edhe z.Kupina dhe se gjendje tani është zgjidhur .

Pika e peste - të Ndryshme

Heten Kupina tha se duhet qe problemin e parave me fajde duhet te trajtohet dhe te merren masa parandaluese sepse po ka shume ngatërresa pikërisht lidhur me para e dhëna me fajde, të identifikohen personat dhe te merren masa adekuate dhe preventive .

Safet Jashari komandant i policisë -veriut është duke u hartuar plani që të behën trajnime prej niveleve me të ultë neper shkolla dhe institucionet gjegjëse që te identifikohen peronat që e ushtrojnë këtë dukuri dhe te raportohen raste në polici ,pastaj edhe viktimat që kanë rënë nga trafikantet të kërkojnë përkrahjen e policisë e të cilën ne ju ofrojmë çdo herë.

Shkelzen Gjafa komandant i policisë qendra te ngritët kjo çështje edhe nga KLSP të dhe qytetaret duhet të janë te hapur dhe te lajmërojnë policinë për rastet e dyshimta dhe personat që merrem me fajde kontaktet çdo kund që hasin situata të dyshimta kanë vendin dhe përkrahjen tonë .

Idriz Xhigolli përfaqësues i fesë islame - ne si bashkësi islame çdo xhuma ne japim ders - ligjërata pikërisht për dukurit te ndryshme negative siç janë rastet e fatkeqësive ne trafik , pastaj shumë herë kemi diskutuar edhe për marrjen e parave me fajde sepse edhe feja myslimanë është kundër këtyre kësaj dukuri te keqe për xhematin tonë . gjithashtu ne ndihmojmë te varfërëtë. Sipas një shantazhi kemi një papunësi prej 40% por ne me fuqinë e zotit punojmë me të rinjtë për ti aftësuar për rrugën e drejt .

Komandant i policisë se Gani Berisha jugu i kemi dy persona me te meta psikike Bajram Ajvazi dhe tjetri me emrin Bedri te cilët na shkaktojnë probleme të shumta duke i vjedhur qytetaret gjuanjë me gurë gra dhe fëmijët pafajshëm edhe ne jemi shume ne halle me ta sepse nuk mundemi te qasemi me metoda te lehta i largojmë kthehen prapë , pastaj njeri ka bere si vendqëndrim Ulpianën te kisha ,këta nuk kane përgjegjësi penale , shpesh dërgohen e dhe ne Shtime por as atje nuk rehatohen kthehen prapë.

Selim Pacolli nënkyrytarë i Komunës tha se as me peronat qe kërkojnë lëmoshë nuk i kemi mirë punët i sulmojnë fëmijët ,gratë ,te moshuarit ,gjykata duhet të nxjerre vendime për këto raste ,për ti dërguar ne vendet përkatëse siç është qendra korrektuese në Shtime .

Përfaqësuesi i kishës tha se te kam pusi universitar sillen në mënyra të ndryshme frikësojnë qytetare.

Lulzim Shehu përfaqësues i besimit të tarikateve kërkojë qe te selia e tyre te behet ndriçimi dhe se aty frekuentojnë edhe qëndrojnë përfaqësues diplomatik , ndërsa sa i përket participimit nga ana e banoreve nuk është problem ne do të kontribuojmë.

Procesmbajtsja

Hateme Gashi

Kryesuesi i Mbledhjes së KKSB-së

Shpend Ahmeti

